



Avokat Ahmet TAHIRI

Adresa: Rr. "Sylejman Vokshi" 3/6, 10000, Prishtinë

P.O. BOX 20, Tel. +383(0) 45562561

Email: ahmet.tahiri@kshk.org

Republic of Kosovo

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR I KOSOVËS
SEKRETARIAT SUDSKOG SAVETA KOSOVO
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL SECRETARIAT

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS
PRISHTINË

09, 59
DAT. DT. 24. 05. 23
PRISHTINË

Nga: Ahmet Tahiri Avokat nga Prishtina, Rr. Sylejman Vokshi 3/6 Prishtinë, përfaqësues me autorizim i Naser Pajazitaj nga Strelci Deqan në baza të neni 526 par.2 dhe neni 529 par. 1 pika 1.2 të KPPRK-së

Për: Komisionit për kompensim dëmi personave të privuar nga liria pa bazë

Lënda: KËRKESË PËR KOMPENSIM TË DËMIT PËR PERSONIN E PRIVUAR NGA LIRIA PA BAZË

Arsyetim

Duke vendosur lidhur me Kërkesën për Caktimin e Paraburgimit të Prokurorisë së Themelore në Pejë ndaj të dyshuarit tani të dëmtuarit **Naser Pajazitaj** me adresë banimi: Strelcë i Ulët. Komuna Decanit, lidhur me dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale "vrasje e rëndë" nga neni 173 par.1 nenpar.1.12 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe veprat penale "mbajtje në pronësi kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374 par 1 të KPPK-së

Gjykata Themelore në Pejë më datë 22.12.2015 ka marr Aktvendim duke i caktuar masën e PARABURGIMIT në kohëzgjatje fillimisht prej 1(një) muaji, përkatësisht prej datës **22.12.2015** deri më datën **06.03.2018**, ku fillimisht lirohet nga akuza dhe me datë **25.03.2019** prap caktohet masa e paraburgimit deri me datë **06.04.2023** ku Gjykata Supreme e Kosovës me Akgjykimin **Pml.NR.57/23** liron Naser Pajazitaj nga akuza lidhur me veprën penale "vrasje e rëndë" ndërsa lidhur me veprat penale "mbajtje në pronësi kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve" Gjykata Supreme E Kosovës vërteton dënimin unik në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj burgim. Të dëmtuarit Gjykata me Aktvendime të njëpasnjëshme i ka vazhduar masën e paraburgimit deri më datë **06.04.2023 në ora 15:00** dhe atë në bazë të AKTGJYKIMIT **Pml.NR.57/23** të datës 06.04.2023, me ç'rast paraburgimi i është ndërprerë me Aktgjykim lirues.

Pra, i dëmtuari ka qëndruar në paraburgim prej datës **22.12.2015** deri më datën **06.03.2018** dhe nga data **25.03.219** deri më datën **06.04.2023** në ora 15:00.

Rrjedhimisht duke pasur parasysh se ligjërisht është vërtetuar se tani i dëmtuari është privuar nga Liria pa bazë juridike – siç u cek më lartë – në periudhë kohore prej 1791 ditësh, *(duke mos llogaritur periudha kohore për të cilën është dënuar për veprat penale “mbajtje në pronësi kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374 par 1 të KPPK-së)* si dhe duke u bazuar në të drejtën ligjore për kompensim dëmi, në cilësinë e të autorizuarit paraqesim këtë kërkesë për kompensim Dëmi si në vijim:

1. Në emër të qëndrimit në Paraburgim prej 1791 ditësh në shumën prej 107,460.00 Euro (njëqind e shtatë mijë e katërqin e gjatëdhjet duke llogaritur një ditë qëndrimi në paraburgim shumën prej 60 euro).
2. Në emër të së paku 144 vizitave familjare në paraburgim shumën prej 14,400.00 Euro (katërbëdhjetmijë e katërqind euro).
3. Në emër të fitimit të humbur shumën prej 28,800.00 Euro (njëzet e tetmijë e tetëqind euro)
4. Në emër të dëmit jomaterial (moral) shumën prej 1,000,000.00 Euro (një milion euro).
5. Në emër të përpilimit të kërkesës për kompensim dëmi shumën prej 325.00 Euro (treqin e njëzet e pesë euro).

Prishtinë, datë 23.05.2023

Parashtruesi i kërkesës përmes të autorizuarit:


AV. AHMET TAHIRI
Ahmet Tahiri
Tel: 045/562-661
E-mail: tahirilaw@gmail.com
P.O. BOX Nr.29, 10000 PRISHTINE-KOSOVË

Shtojcë:

1. Aktgjykimi e Gjykatës Themelore nw Pejw DKR.P.nr.59/2017, dt 06.03.2018
2. Aktgjykimi e Gjykatës Themelore nw Pejw PKR.nr.83.2019, dt23.04.2019
3. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme te Kosoves Pml.nr.57/2023, dt 06.04.2023
5. Autorizimi i avokatit i noterizuar.